

Republika e Shqipërisë
M.B.U.M.K. | AKU
Nr. Prot. 77
Datë 30.06.2011

L. Stanger
Z. Kthupi

30/06/2011

akti i ushqimit
1.07.2011

te drejtoreshat uadeti
DP.
duy



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
MINISTRI

Nr. 21/6 Prot.

Tiranë, më 21/6 /2011

URDHËR

Nr. 21 Datë 21/6 /2011

*Të matohen drejt.
raportat në lidhje
me këtë urdhër.*

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PRODUKTET USHQIMORE PËR
PËRDORIM TË VEÇANTË USHQIMOR”

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin”, nenit 76 të ligjit nr. 9590, datë 27.07.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian e shteteve të tyre anëtare” dhe vendimit nr. 463, datë 05.07.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Planit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit”, i ndryshuar me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për produktet ushqimore për përdorim të veçantë ushqimor”, bashkëlidhur këtij Urdhëri.
2. Urdhëri nr.568, datë 22.12.2008 “Për miratimin e rregullore “Për produktet ushqimore për përdorime ushqimore të veçanta””, shfuqizohet.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhëri, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
GJENERALI
TIRANË

RREGULLORE

“PËR PRODUKTET USHQIMORE, PËR PËRDORIM TË VEÇANTË USHQIMOR”

1. Kjo rregullore përcakton rregullat për produktet ushqimore për përdorim të veçantë ushqimor.
2. Produktet ushqimore për përdorim të veçantë ushqimor, janë produktet që sipas përbërjes së tyre të veçantë ose procesit të prodhimit dallohen qartë nga ushqimet për konsum normal, janë të përshtatshme për qëllimet e tyre si dhe tregtohen në mënyrë që të tregojnë këtë përshtatshmëri.
3. Produktet ushqimore për përdorim të veçantë, duhet të përmbushin kërkesa të veçanta ushqimore për:
 - (a) një kategori të caktuar personash të cilët kanë çrregullim në procesin tretës ose në metabolizëm;
 - (b) një kategori personash të cilët janë në kushte të veçanta fiziologjike dhe që mund të marrin përfitime të veçanta nga konsumimi i kontrolluar i disa substancave të caktuara në produktet ushqimore;
 - (c) foshnje ose fëmijë të vegjël në gjëndje të mirë shëndetësore.
4. Produktet sipas përcaktimit në pikën 3 (a), (b) cilësohen si “dietë” ose “racion ushqimor”.
5. Në etiketimin, prezantimin dhe reklamimin e produkteve ushqimore për konsum normal nuk lejohet:
 - (a) përdorimi i fjalëve “racion ushqimor” ose “dietë” vetëm ose lidhur me fjalë të tjera për të emërtuar këto produkte ushqimore;
 - (b) shenja ose ndonjë paraqitje që krijon përshtypjen se bëhet fjalë për ndonjë nga produktet e përcaktuara në pikën 3.
6. Natyra ose përbërja e produkteve që përcaktohen në pikën 3, duhet të jetë e tillë që këto produkte të jenë të përshtatshme për përdorimin e veçantë ushqimor për të cilin janë prodhuar.
7. Produktet e përcaktuara në pikën 3, duhet të plotësojnë dhe kërkesat e detyrueshme të zbatueshme për produktet ushqimore për konsum të zakonshëm.
8. Kërkesat e veçanta për grupet e produkteve ushqimore për përdorim të veçantë ushqimor të dhëna në aneksin 1, bashkëlidhur kësaj rregulloreje, përcaktohen në :

Urdherin e Ministrit nr.456 datë 17.12.2007 “Për miratimin e rregullores “Për formulat ushqimore për foshnja dhe formulat rrjedhëse””;

Urdherin e Ministrit nr.146, datë 29.04.2009 “Për miratimin e rregullores “Për ushqimet për përdorim në dietat me energji të kufizuar për ulje në peshë””;

Urdherin e Ministrit nr.94, datë 26.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Mbi ushqimet e përpunuara me bazë drithërat dhe ushqimet për foshnje dhe fëmijë të vegjël””;

Urdherin e Ministrit nr.176, datë 28.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Mbi ushqimet dietike për qëllime të veçanta mjekësore””.

9. Vendosja në treg e produkteve ushqimore për përdorim të veçantë ushqimor, që rezultojnë të tilla nga progresi shkencor dhe teknologjik, bëhet sipas legjislacionit në fuqi për ushqimin.

10. Lista e substancave për qëllime ushqimore specifike si vitamina, kripëra minerale, aminoacide, substanca të tjera që shtohen në ushqime të destinuar për përdorim të veçantë ushqimor, kriteret e pastërtisë dhe kur është e përshtatshme, kushtet nën të cilat ato duhet të përdoren, përcaktohen në Urdhërin e Ministrit nr.320 datë 2.11.2010, “Për miratimin e rregullores “Për substancat që mund të shtohen për qëllime të veçanta ushqimore në ushqime për përdorim të veçantë ushqimor””.

11. Mënyra dhe metodat e përdorura për etiketimin, paraqitjen dhe reklamimin e ushqimeve të përcaktuara në pikën (2) nuk duhet t'i atribuojnë ose të nënkuptojnë për keto produkte, përmbajtjen e vetive të tilla të cilat parandalojnë, trajtojnë ose mjekojnë sëmundjet në njerëz.

12. Emërtimi me të cilin shitet një produkt për përdorim të veçantë ushqimor, shoqërohet me një tregues të karakteristikave të tij të veçanta ushqimore. Megjithatë, në rastin e produkteve të përcaktuara në pikën 3 (c), ky tregues zëvendësohet me përcaktimin e qëllimit për të cilin ato përdoren.

13. Etiketimi i produkteve për përdorim të veçantë ushqimor, të cilat nuk janë përcaktuar në dispozitat e rregulloreve të miratuara me urdhërat sipas pikës 8, duhet të përfshijë:

- (a) tregues të veçantë për përbërjen cilësore e sasiore ose për procesin e veçantë të prodhimit, të cilat i japin produktit karakteristika të veçanta ushqimore;
- (b) vlerën e përmbajtjes së energjisë të shprehur në kilo-xhaul dhe kilo-kalori, përmbajtjen e karbohidrateve, proteinave dhe yndyrnave për çdo 100gr ose 100 ml të produktit dhe kur është e mundur, përcaktimin e këtyre vlerave edhe për sasi të tjera të caktuara të produktit.

14. Nëse vlera e energjisë është më pak se 50 kilo-xhaul (12 kilokalori) për çdo 100 gr ose 100 ml produkt, të dhënat e përcaktuara më lart mund të zëvendësohen me fjalët “vlera e energjisë më pak se 50 kilo-xhaul (12 kilokalori) për çdo 100 gr ose “vlera e energjisë më pak se 50 kiloxhaul (12 kilokalori) për çdo 100 ml”.

15. Produktet e përcaktuara në pikat 2 dhe 3 tregtohen në formë të parapaketuar, në mënyrë që ambalazhi të mbulojë dhe mbrojë këtë produkt.

16. Me qëllim që të sigurohet një kontroll zyrtar i përshtatshëm për ushqimet për përdorim të veçantë ushqimor të cilat nuk bëjnë pjesë në grupet e listuara në Aneksin 1, zbatohen kërkesat specifike si mëposhtë:

- (a) kur një produkt tregtohet për herë të parë, prodhuesi ose importuesi duhet të lajmërojë Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, duke paraqitur paraprakisht një model të etiketës së përdorur për produktin;
- (b) kur është e nevojshme, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit i kërkon prodhuesit ose importuesit të paraqesë të dhëna shkencore, të dhëna për plotësimin e kërkesave të përcaktuara në pikën 2 dhe 3 si dhe informacionin e përcaktuar në pikë 13 (a).

17. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit bllokon produktet për përdorim të veçantë ushqimor, që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në pikat 2 dhe 3, sipas legjislacionit në fuqi për ushqimin.

Kjo rregullore hyn në fuqi me nënshkrimin e saj.

MINISTRI

GENC RULI



ANEKSI I

A. Grupet e produkteve ushqimore për përdorim të veçantë ushqimor:

1. Formulatat ushqimore për foshnje dhe formulatat rrjedhëse;
2. produktet e përpunuara me bazë drithrat dhe ushqimet për foshnje dhe fëmijë të vegjël;
3. ushqimet që përdoren në dieta me energji të kufizuar për reduktimin e peshës;
4. ushqimet dietike për qëllime mjekësore të veçanta;
5. ushqimet që përdoren për të plotësuar harxhimet nga tendosjet e mëdha muskulare veçanërisht për sportistët.

B. Grupet e produkteve ushqimore për përdorim të veçantë ushqimor, sipas procedurave të caktuara:

Ushqimet për personat që vuajnë nga çrregullime në metabolizmin e karbohidrateve (diabeti).



REPUBLIKA E SHQIPERISE
 MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
 AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT
 DREJTORIA RAJONALE E QARKUT KORÇË

Republika e Shqipërisë
 M.B.U.N.K. AK
 Nr. Prot. 1024
 Datë 18.08.2011

Nr. 266 Prot.

Znj. Struga

Korce me 17/08/2011

18/08/2011

LENDA: Kerkohet mbeshtetje teknike per Inspektoret e P.K.K. -ve

DREJTUAR: Znj. Ariela Struga

Drejtor i Menaxhimit te Riskut dhe
 Koordinimit te Inspektimit

Perdijeni: Z. GENC JUKA

Drejtor i Pergjithshem i A.K.U.

28.08.2011
C. Gjergji
A. Belegu
A. Kusoviqi
15
Armenia
Projeuri per
inspektoret e P.K.K.

Sikunder jeni ne dijeni kemi perfunduar lidhjen e kontratave me 12 Inspektoret e Sektoreve te tjere qe kaluan si Inspektore karantine duke bere dorezimin e vulave perkatese dhe dokumentacionin dhe mbas disa diteve edhe zevendesimin e 6 Inspektoreve te tjere.

E shohim te nevojshme, te domosdoshme dhe urgjente ndihmesen dhe mbeshtetjen teknike nga ana e Specialisteve perkates tuaj te cilet ne grup prane dy pikave te kalimit kufitar Qafe Thane dhe Kapshtice te bejne trajnimin e praktikave te punes dhe dokumentacionit perkates.

OK

DREJTORI

Veniamin NAPUCE

